



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

FORMAT APLIKIMI

KONKURSII PRAKTIKAVETË MIRA TË QEVERISJES VENDORE
EDICIONI 2017

| | |
|--------------------------------|-------------------------------|
| Titulli i praktikës: | Sherbimi i transportit publik |
| Bashkia: | Fier |
| Periudha e zbatimit: | 2016-2017 |
| Rajoni: | Fier |
| Autori (ët) e aplikimit | Bashkia Fier |

1. **Fusha e aplikimit për praktikat më të mira dhe demonstrimi i kohezionit social, ekonomik apo territorial** (shkruani fushën për të cilën po aplikohet dhe jepni shpjegime mbi kohezionin e siguruar)

Fusha ku po aplikohet është “Transporti Publik”.Pas implementimit të reformës administrative territoriale është rritur numri i popullsisë dhe kjo ka bërë që sherbimi i transportit të përfshijë interesin e shumë qytetareve.Transporti publik është një pike shumë e rëndësishme në përballjen e sfidave ekonomike energjitike dhe mjedisore të qytetit tone duke permisuar ndjeshëm cilësinë e jetesës.Rritja e numrit të qytetareve që zgjedhin transportin publik tregon se çdo segment i shoqërisë tone-individet,familjet,komunitetet dhe bizneset përfitojnë nga transporti publik.

2. Përshkrimi i **problematikës** së adresuar (jo më tepër se 100 fjalë)

Fieri është një nga qendrat urbane më të zhvilluara në Shqipëri dhe Jugut.Pas reformës administrative-territoriale në Fier llogaritet një popullsi prej 200 mijë banorësh,dendësi 287 banorë/km² dhe sipërfaqe 682.7 km².Sherbimi i transportit publik ka qenë gati inekzistent në qytetin tone.Mungesa e terminaleve të autobuzëve rrethqytetit,cilësia e mjeteve të udhëtimit si edhe mosrespektimi i orareve kanë qenë ndër problematikat kryesore të transportit urban.Rritja e trafikut ,rritja e mjeteve levizese shoqëruar me levizjet e medha demografike pas implementimit të reformës administrative territoriale, diktuan nevojën për përmirësimin e sherbimit të transportit rrethqytetit.Bashkia Fier duke parë gjendjen e transportit publik ekzistues si edhe për të mbuluar me transportin e udhëtarëve sa të jete e mundur territorin e saj vjen me një sherbim të ri në fushën e transportit publik.

3. Veprimtaritë kryesore dhe **rezultatet** e arritura (jo më tepër se 150 fjalë)

Bashkia e Fierit hartoi nje rrjet te linjave rrethqytetase dhe nderqytetase duke u bazuar mbi te dhenat demografike e gjeografike,gjendjen social ekonomike,kerkesat per levizjen e popullates,rrjetin rrugor dhe gjendjen e infrastrukstures rrugore.Sot ne qytetin e Fierit operojne 15 linja rrethqytetese dhe 1 linje nderqytetese.Numri i personave qe perdorin sherbimin e transportit publik si e vetmja mundesi transporti per pjesen me te madhe te tyre eshte mjaft i lart,Ky sherbim ofrohet sipas standarteve te duhura dhe eshte prezent dhe i dukshem.Sot vihet re prezenca e stacioneve te autobuzeve dhe kabinave per pasagjeret si edhe eshte ne ndertim e siper terminali i autobuzeve te qytetit te Fierit,Ky terminal do te sherbeje per grumbullimin e pasagjereve,parkimin dhe nisjen e autobuzeve te linjave interurbane dhe urbane sipas destinacioneve perkatese.Ne cdo stacion autobuzi eshte i afishuar orari i qarkullimit te autobuzeve.Keta autobuze jane te pajisur me te gjithe parametrat e komoditetit dhe kane kapacitetet te bollshem ne raport me numrin e pasagjereve qe i frekuentojne.Higjena e perdorimi i kondicionereve eshte nje tjetere vlere e shtuar e ketij sherbimi.

4. A mund të përshkruhet ndërhyrja si **inovative** (jo më tepër se 100 fjalë)

Implementimi me sukses i ketij sherbimi eshte mjaft i rendesishem pasi ka ndikur drejtperdrejte ne permiresimin e jeteses se qytetareve si dhe ne nxitjen e zhvillimit ekonomik,social dhe mjedisor.Ky sherbim ka shkurtuar distancat dhe ka rritur komunikimin mes qytetareve.

5. **Informimi** e pjesëmarrja komunitare (jo më tepër se 100 fjalë)

Komuniteti e ka mirepritur kete sherbim te munguar per qytetaret e Fierit.Ekzistenca e ketij sherbimi eshte pasqyruar ne mediat lokale.Ne cdo stacion autobuzi eshte i afishuar orari dhe destinacioni i sakte i cdo linje.

6. **Qëndrueshmëria** e praktikës (jo më tepër se 100 fjalë)

Ky sherbim ka nje impakt teper te madh ne qytet.Qyteti i Fierit ka nje transport urban te konsoliduar te mireorganizuar ne hapesire dhe orare,por mbi te gjitha nje transport urban lehtesisht te aksesueshem nga qytetaret.

7. **Ilustrime** lidhur me praktikën (1-2 ilustrime, foto, video, gazeta)



FIER - POJAN

ARJANI TRAVEL

DALJE

www.arjanitravel.com



Konfirmoj se informacioni i dhënë në dokumentet e këtij aplikimi është i saktë.

Sinqerisht,

Kryetar

Armando SUBASHI